



DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & TE BARABARTE

RAPORTI VJETOR 2014

PËRMBAJTJA

I. Projektet e zbatuara gjatë 2014 dhe donatorët

II. Përfituesit e programit

- a. *Profili i rasteve VeT / VMT*
- b. *Profili i rasteve viktime të dhunës në familje*

III. Shtyllat kryesore të punës së D&E gjatë vitit 2014

- a. *Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktime të trafikimit*
- b. *Kontributi në kthimin e asistuar të Viktimave të trafikimit apo VMT*
- c. *Asistencë direkte për meshkuj viktime të trafikimit*
- d. *Rritja e përpjekjeve për identifikimin e VT*
- e. *Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave të trafikimit*
- f. *Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale*
- g. *Aktivitete ndërgjegjësuese për respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri*
- h. *Aktivitete për të parandaluar trafikimin dhe promovuar migracionin e sigurt*
- i. *Aktivitete për parandalimin e dhunës seksuale*

IV. Trainime dhe prezantime të ofruara nga D&E

V. Pjesëmarrja e stafit në trainime

VI. Koordinime me Aktorë të tjerë Kundër Trafikimit

VII. Botime të D&E

I. PROJEKTET E ZBATUARA GJATË 2014

Projekti 1: “Rritja e përpjekjeve për riintegrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri”

Donator: King Boudouin Foundation, Pro Victims

Kohëzgjatja: - KBF perfundon Dhjetor 2014

Pro Victims 1 Tetor 2014 – 30 Shtator 2015

Projekti 2: “Sigurimi i asistencës riintegruese të qëndrueshme për Viktimat e Trafikimit dhe atyre në risk trafikimi”

Donator: UNODC, MIVA

Kohëzgjatja: - perfundon Dhjetor 2014

Projekti 3: “Forcimi i përpjekjeve të Shqipërisë për një përpjekje efikase dhe të qëndrueshme kundër trafikut të qënieve njerëzore”

Donator: JTIP/IOM

Kohëzgjatja: perfundoi Gusht 2014

Projekti 4: “Vulnerabiliteti ndaj trafikimit dhe faktorët e riskut: Parandalimi i trafikimit dhe mbështetja e migracionit të sigurt në komunitetet e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë”.

Donator: Ministria e Jashtme Norvegjeze

Kohëzgjatja: perfundoi Nëntor 2014

Projekti 5: “Anti-Trafficking in Persons: Training of Trainers and Community Education Program”, në bashkëpunim me US Peace Corps Albania Anti-Trafficking in Persons Committee (ATIP).

Donator: Ambasada Amerikane në Tiranë

Kohëzgjatja: 2014 – 2015 (12 muaj)

Projekti 6: "Qendër për aktivitete edukative për Viktimat e Trafikimit"

Donator: Mary Ward Loreto

Kohëzgjatja: 2 vjet (vazhdon)

Projekti 7: “Cikli i këshillimit”

Donator: Swiss Contact

Kohëzgjatja: në vazhdimësi

Projekti 8: “Rritja e përpjekjeve riintegruese për viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore në Shqipëri dhe ofrimi i aktiviteteve ndërgjegjësues për personat në nevojë dhe profesionistet kyç”

Donator: Renovabis

Kohëzgjatja: Nëntor 2014 – Tetor 2017 (3 vjet)

Projekti 9: “Zgjerimi i veprimtarisë së "NYT Bagels", një biznes social në Tiranë”

Donator: RSBF

Kohëzgjatja: Qershor 2014 – Qershor 2015

Projekti 10: “Studim mbi çështjet e bashkëpunimit të viktimave të trafikimit me autoritetet e zbatimit të ligjit”

Donator: OSCE

Kohëzgjatja: Qershor – Dhjetor 2014

II. PËRFITUESIT E PROGRAMIT

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2014 janë asistuar në programin riintegruar të organizatës 103 përfituese dhe 60 fëmijë të tyre nga të cilat 53 raste dhe 33 fëmijë kanë hyrë për herë të parë në program gjatë kësaj periudhe, ndërsa rastet e tjera janë të mbartura nga viti i kaluar dhe kanë vazhduar të marrin ndihmë sipas planit të riintegritimit. Nga 53 rastet e reja, **40 raste janë viktimë /viktimë të mundshme të trafikimit** dhe 13 rastet e tjera janë viktimë të abuzimit e dhunës në familje.



Kategoritë e përfitueseve të asistuar në program

Kategori	Total i rasteve të asistuar në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2014	Rastet e mbartura nga Dhjetor 2013	Rastet e reja në program gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2014
Viktima trafikimi	35	26	9
Viktima të mundshme trafikimi	50	19	31
Viktima të dhunës dhe abuzimit	18	5	13
Fëmijë të VeT shoqëruar me nënat e tyre	29	17	12
Fëmijë të VDH shoqëruar me nënat e tyre	31	10	21
Totali	163	77	86

- PROFILI I RASTEVE VIKTIMA / VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI

Gjinia


Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja
Femra	36	31
Meshkuj	9	9
TOTAL	45	40



Mosha

Mosha	14-17	18-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Numri i rasteve	15	15	4	3	3	40
Përqindja	37.5%	37.5%	10%	7.5%	7.5%	100%


Lloji i shfrytëzimit:¹



Mënyrat e rekrutimit

Mënyrat e rekrutimit	Nr
Premtim i rremë për martesë / Martesë	6
Premtim i rremë për punë	3
Rrëmbim	2
Mashtrim nga i dashuri	5
Shfrytëzim i situatës vulnerabël / mashtrim	20
Premtim për akomodim e ushqim falas, mbrojtje dhe punësim	1
Ndikimi i grupit social për tu përfshirë në situatë të rrezikshme, në shfrytëzim	2
Shfrytëzim nga anëtarë të familjes	1
TOTAL	40

¹ Disa raste janë shfrytëzuar për më shumë se një qëllim



Referimet e rasteve sipas muajve

40 raste dhe 12 fëmijë kanë hyrë në program gjatë kësaj periudhe.

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	2	0
Shkurt	4	2
Mars	2	2
Prill	3	1
Maj	4	1
Qershor	4	-
Korrik	4	2
Gusht	1	1
Shtator	5	2
Tetor	7	-
Nëntor	-	1
Dhjetor	4	-
Total	40	12

Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar – Dhjetor 2014:

Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	2
Drejtoria e Plicisë, ZRSHSSH - Tiranë	2
Drejtoria e Plicisë, ZRSHSSH – Tiranë / Mobile Unit Tirana	1

Drejtoria e Policisë, Berat	2
Drejtoria e Policisë, ZRSHSSH - Durrës	2
ZRSHSSH - Lezhë	3
ZRSHSSH - Shkodër	1
QKPVT	4
Shoqata “Tjetër Vizion”, Elbasan	4
Qendra “Vatra”, Vlorë	3
ARSIS	5
Aleanca LGBT	2
Organizata “Global Care”	1
Psikologe, shkolla “Hasan Koci”, Durrës	1
OSCE	1
IOM Tirana	1
Njësia Lëvizëse, Tiranë	2
Sisters of our Lady of Charity Redcote Convent/ Angli	1
Organizata “Solwodi” në Gjermani	2
TOTAL	40

2 prej rasteve viktime trafikimi dhe viktime e mundshme trafikimi janë të huaja dhe janë shfrytëzuar njëra në Shqipëri për punë të detyruar dhe tjetra në Shqipëri dhe Itali shfrytëzuar seksualisht.


- ***PROFILI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE***

Gjinia

Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja
Femra	5	13
TOTAL	5	13

Mosha

Mosha	18-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Numri i rasteve	2	3	2	6	13
Përqindja	%	%	%	%	100%



Referimet e rasteve sipas muajve


13 raste dhe 21 fëmijë kanë hyrë në program gjatë kësaj periudhe.

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	-	-
Shkurt	1	-
Mars	1	3
Prill	1	1
Maj	2	3
Qershor	2	2
Korrik	-	-
Gusht	2	2
Shtator	2	8
Tetor	-	-
Nëntor	2	2
Dhjetor	-	-
Total	13	21

Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë Janar – Dhjetor 2014:

Burimet e referimit

- Komisarjati i Policisë Nr.3
- Shërbimi Social Shtetëror
- Forumi i Gruas, Elbasan
- Qendra Kombëtare e viktimave të dhunës në familje
- ARSIS
- Qendra "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci"
- Motrat e Nënë Terezës



III. SHTYLLAT KRYESORE TË PUNËS SË D&E GJATË VITIT 2014

Aktivitetet kryesore të zbatuara nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” për periudhën Janar - Dhjetor 2014 janë:

- a. Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktime të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe dhunës në familje
- b. Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit apo VMT
- c. Asistencë direkte për meshkuj viktime të trafikimit
- d. Rritja e përpjekjeve për identifikimin e VT
- e. Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave të trafikimit
- f. Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale
- g. Aktivitete ndërgjegjësuese për respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri
- h. Aktivitete për të parandaluar trafikimin dhe promovuar migracionin e sigurt
- i. Aktivitete për parandalimin e dhunës seksuale

a. ASISTENCË DIREKTE PËR VAJZAT DHE GRATË VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Gjatë vitit 2014 D&E ka vazhduar të ofrojë asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit në tre faza:

Faza #1: Ndërrhyrja në situatë krize dhe Akomodimi

Faza #2: Faza tranzit e cila përfshin jetesën gjysëm të pavarur

Faza #3: Riintegrimi dhe përfshirja sociale

Një paketë e plotë e shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit e programit të riintegrit të D&E: Strehim, siguri dhe plan riintegrimi; Asistencë e menjëhershme mjekësore; Negocim/ndërmjetësim me familjen; Vlerësime dhe këshillime psikologjike; Mbështetje dhe asistencë ligjore; Asistencë për rregjistrim / vazhdimësinë e sistemit shkollor; Trajnime profesionale; Aktivitete sociale; Këshillim dhe ndihmë për punësim; Mbështetje financiare për strehim; Informacion mbi shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme/ harta e shërbimeve; Programe pune që krijojnë të ardhura; Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit; Monitorim dhe ndjekja e mëpasshme e përfitueseve të programit.

Përveç asistencës direkte me përfitueset, D&E ka punuar e mbështetur dhe familjen e viktimës-p.sh fëmijët e përfitueses, asistencë për familjet e përfitueseve (prindërit, motrat apo vëllezërit) në mundësinë e gjetjes së një pune, shoqërimi dhe rregjistrimi tek Zyrat e Punës, ndihmë me paketë ushqimore, përfshirja në programe apo shërbime të ofruara nga sigurues të tjerë shërbimesh në komunitet, rregjistrimi në kurse profesionale, këshillim familjar, etj.

Shërbime psikologjike e sociale

Një rëndësi të veçantë i kushtohet mbështetjes dhe rikuperimit psikologjik, duke e parë atë si zhvillim shumë të rëndësishëm në procesin e riintegrit.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2014, janë realizuar në total 3895 seanca këshillimi nga punonjëset sociale, psikologu, koordinatori i qendrës së edukimit dhe menaxheri i strehëzës. Duke iu referuar shërbimit psiko-social janë realizuar:

- ***Këshillim individual*** psikologjik dhe psiko-social në RC dhe në Qendrën e Edukimit;
- ***Këshillimi në Grup;***
- ***Terapi arti;***
- ***Terapia okupacionale;***

- Këshillimi psikologjik individual

Këshillimi psikologjik ka ndihmuar përfitueset në fitimin e disa aftësive për menaxhimin e stresit dhe në rikuperim. Gjatë kësaj periudhe 1 vjecare, këshillimi psikologjik individual është ofruar për përfitueset e tre fazave të programit.

Për rastet e reja të cilat kanë hyrë në program, fillimisht është bërë vlerësimi i nevojave psiko-sociale. Vlerësimi ka ndihmuar psikologun dhe rastet të fokusohen në çështjet primare për ndërhyrje të menjëhershme.

Pas hartimit të planit të ndërhyrjes, janë mbështetur rastet si më poshtë:

Përfitueset në Fazën I të programit, që asistohen në strehëz, janë mbështetur me 2 deri në 3 seanca këshillimi në javë, në varësi të kësaj nevojave dhe rastit. Këshillimi është zhvilluar në ambientet e strehëzës për përfituesit që janë asistuar aty.

Përfitueset në Fazën e II të programit të cialt jetojnë në apartamente me qera dhe familje janë mbështetur me një séance në javë ose një seancë në dy javë. Kjo gjithashtu është përcaktuar pas një vlerësimi të rastit dhe nevojave specifike. Për përfitueset në fazën e dytë të programit, këshillimi psikologjik është ofruar në ambientet e Qendrës Edukative. Për përfitueset në rrethet, të cilat e kanë pasur të pamundur të udhëtojnë, janë ofruar disa seanca këshillimi në qytetet e tyre. Është udhëtuar në Korçë, Elbasan, Vlorë për ofrimin e disa seancave për rastet të cilat e kishin të pamundur të udhëtonin për shkak të rrethanave.

Përfitueset në Fazën III të programit, janë asistuar me seanca këshillimi në varësi të nevojave duke iu përshtatur gjithashtu situatave të tyre në kohën kur është ofruar këshillimi.

Puna me rastet është fokusuar në eksperimentat traumatike të hershme dhe të vona që lidhen me trafikimin dhe shfrytëzimin, eksperiencat të përdhunimit dhe abuzimit seksual, humbjet, rrëmbimet, abuzimi prindëror, dhuna në familje etj. Disa nga çështjet e sjella nga përfitueset janë si më poshtë:

- Menaxhimi i reagimeve ndaj traumave
- Teknika të relaksimit dhe teknika të menaxhimit të ankthit.
- Paqëndrueshmërinë emocionale
- Stresi dhe ankthi përpara proceseve gjyqësore
- Përballja me probleme të vazhdueshme familjare
- Kriza në marrëdhënie personale
- Trajtimi i çështjeve të varësisë, besimit, ndjenjave të fajit, dashurisë
- Ndërgjegjësimi për nevojat
- Menaxhimi i zemërimit

- Probleme të gjumit, pagjumësi, makthe
- Zhvillimin e aftësive problem-zgjidhëse, për të ndihmuar rastin në menaxhimin dhe lehtësimin e zgjidhjeve, identifikimin e përgjigjeve të mundshme për problemet, etj.
- Simptoma të Ankthit dhe Depressionit.

“Ajo që më ka bërë babai ishte e tmerrshme për mua. Kam qëndruar shumë kohë pa i treguar askujt për këtë ngjarje. Ndhem shumë e lehtësuar që më në fund mund të flas” A.S

“Nuk do t’ja fal kurrë vetes që u gjenda në atë situatë! Duhet të isha mbrojtur, të kisha gjetur një mnëyrë si të shpëtoja!” O.P

“Nuk mund t’i tregoj mamit dhe babit për atë që më ka ndodhur. Ato do më fajësonin mua, jam shumë e sigurt! Qe kur ndodhi kjo gjë e tmerrshme askush nuk më afrohet dhe në shkollë qëndroj vetëm!” L.U

“Më duket ndonjëherë që nuk do të kem asgjë të mirë në jetë. Më është shkatërruar jeta” K.J

- Terapia e artit


Prej disa vitesh tashmë, Terapia e Artit është një aktivitet sa shërues aq edhe argëtues dhe relaksues për përfitueset. Gjatë vitit 2014, në seancat e Terapisë së Artit kanë marrë pjesë rreth 25 përfituese. Sesionet, të cilat kanë një kohëzgjatje prej 90 minutash, kanë rezultuar të jenë efektive në shprehjen përmes vizatimit dhe artit për tema të caktuara.

Disa nga teknikat dhe ushtrimet gjatë sesioneve;

- Si e shoh veten , si më shohin të tjerët, si dua të jem
- Ëndrra ime
- Vizato një urë
- Krijë botën tënde
- Kolazhi im

“Ndhem shumë në paqe kur pikturoj. Më jep një lloj qetësie” T.G

- Dielli im
- E ardhmja ime
- Pema (Gjethet jeshile dhe ato të rëna)
- Krijimi I vetes
- Më e mira vetes



“Ndonjëherë, kur kemi ndonjë temë në Terapinë e Artit, sikur bllokohehem dhe nuk më vjen asgjë në mendje. Duhet të kalojnë disa minuta që të filloj të mendoj. Pastaj, ka disa tema të tjera në të cilat përfshihem direkt” D.A

- Asistencë psikologjike për fëmijët e përfituesve të programit

Një punë intensive është bërë për ofrimin e ndihmës psikologjike edhe për fëmijët e përfituesve të programit të organizatës “Të Ndëryshëm dhe Të Barabartë”. Gjatë kësaj periudhe janë asistuar 11 fëmijë të moshave 3-13 vjec të cilët kanë shfaqur shqetësime. Janë zhvilluar sesione të Terapisë së Lojës, Terapisë së Artit dhe Tregimeve, në varësi të moshave të fëmijëve. Fëmijët të cilëve u është ofruar kjo mbështetje, kanë qënë të ekspozuar ndaj dhunës dhe në disa raste edhe të abuzuar. Disa nga çështjet kryesore ku është fokusuar puna me fëmijët, lidhet me:

- Probleme gjumin
- Shqetësime të vazhdueshme për kujdestarin
- Tërheqje, izolim, vetëvlerësim i ulët
- Ndjenja të turp, fajit
- Pasiguri
- Ankth dhe Zemërim
- Marrëdhënia me prindërit
- Zakone jo të mira të të ngrënit

Asistencë shëndetësore

Mjekja e D&E ka adresuar dhe trajtuar nevojat mjekësore të përfituesve të programit të riintegritimit. Këto lloje shërbimesh janë ofruar kryesisht për përfitueset që janë të akomoduar

në qendrën e riintegritimit por edhe për ato të cilat janë në fazën e dytë të programit. Pas vlerësimit mjekësor të realizuar nga doktorësja, rastet e reja të sapo hyra në program janë mbështetur të bëjnë analizat rutinë (gjak komplet, urina, ekzaminimet SST, etj).

Katër përfituese shtatzanë janë mbështetur me asistencën e duhur mjekësore që ju është nevojitur gjatë kësaj periudhe.

Diagnoza mjekësore

Sëmundja	Infeksione urinare	Probleme kardiologjike	Probleme dermatologjike	Colic abdominal and renal	ORL problems	Hepatitis	Probleme neurologjike	Probleme alergjike	Probleme gjenekologjike	Anemia	Problemem toksikologjike	Probleme dentrae	Oculist	Vizite tek kirurgu	Gastro-intestinal
Nr. i rasteve	7	1	1	2	14	0	2	2	14	5	0	8	5	1	1
Fëmijë	1				5			1		1				1	

12 përfituese kanë bërë testin HIV/AIDS test mbi baza vullnetare pranë ISHP dhe gjithashtu janë ekzaminuar për Hepatitis B+C. Për të gjitha rastet rezultati ka qenë negativ.

Egzaminime mjekësore

Ekzaminime	SST		HIV/AIDS	
	Ekzaminuar	Positive	Ekzaminuar	Positive
Nr. i rasteve	28	15	12	0

8 përfituese me çrregullime të shëndetit mendor janë ndjekur tek doktori psikiater duke marrë trajtimin e duhur në vazhdimësi.

Probleme të shëndetit mendor

Çrregullime mendore	Çrregullim të stresit post traumatik	Skizofreni	Çrregullim depresiv	Çrregullim e psikotike	Çrregullim ankthi	Total
Numri i rasteve	3	1	1	2	1	8

- D&E ka bashkëpunuar me *Qendrën Shëndetësore (Poliklinikën nr.9)* për regjistrimin e përfitueseve që janë në program, tek doktori i familjes pranë kësaj Qendër Shëndetësore dhe për fillimin e procedurave për t'u pajisur me Libër Shëndeti, në mënyrë që të lehtësojë vizitat mjekësore dhe analizat për të cilat ato kanë nevojw.

- D&E ka bashkëpunuar me “Qendrën për popullsinë dhe zhvillimin”. Qendra siguron shërbime mjekësore si: këshillim për planifikim familjar, fushata ndërgjegjësimit, Riprodhimin, test për HIV/ AIDS, Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme, vizita gjinekologjike dhe trajtime të infertilitetit. Bazuar në marrvëshjen midis D&E dhe Qendrës, disa përfituese, pjesë e programit që kanë rezultuar me IST kanë marrë shërbim gjinekologjik falas.

- D&E ka vazhduar bashkëpunimin me *Albanian University- Dega Stomatologji*, nëpërmjet të cilit janë siguruar shërbime dentare falas për përfitueset e programit dhe gjithashtu me “*Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor nr.2*” dhe ISHP.

- Stafi mjekësor ka organizuar diskutime në grup mbi çështjet e shëndetit si: infeksionet seksualisht të transmetueshme, hepatiti B dhe C dhe mënyrat e mbrojtjes ndaj tyre, alergjitë e sezonale, ushqyerja e shëndetshme e fëmijëve, “HIV/ AIDS dhe ne”, higjiena personale, gripi i derrit - mënyra se si infektohemi dhe si ta mbrojmë veten nga kjo; Parandalimi dhe ndihma e parë në rastet e aksidenteve të ndodhura në ambientet brenda shtëpisë; Rrezatimi djellor – efektet pozitive dhe negative në trupin tonë, si ta mbrojmë veten gjatë sezonit të verës.

Asistencë ligjore

Gjatë vitit 2014, D&E krahas shërbimeve të tjera ka ofruar edhe ndihmë dhe këshillim ligjor për përfituesit e saj. Ndihma ligjore është ofruar për çdo përfitues në varësi të nevojave dhe specifikave të rastit. Për raste të veçanta, për të cilat kërkohet një ekspertizë më profesionale D&E ka bashkëpunuar me organizata të tjera me ekspertizë në fushën e përfaqësimit dhe ndihmës juridike si: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Qendra “ARSIS” dhe Shërbimi ligjor falas “TLAS”. Me këto organizata D&E ka marrëveshje të veçantë bashkëpunimi për të asistuar rastet e referuara nga D&E. Në punën me rastet, përsa i përket ndihmës ligjore, D&E ka bashkëpunuar edhe me institucionet shtetërore si Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Gjykatat, Prokurororinë dhe në veçanti me Policinë e Shtetit.

- Vlerësimet ligjore

Një komponent i rëndësishëm i ndihmës ligjore është vlerësimi i nevojave ligjore për përfitueset e referuara gjatë vitit 2014. Vlerësimi i nevojave ligjore i paraprin të gjithë procesit të ndihmës juridike të realizuar gjatë trajtimit të rasis në qendër dhe jashtë saj.

Takimi i zhvilluar për vlerësimin e nevojave ligjore të rastit ka shërbyer edhe për të informuar përfituesit për të drejtat e tyre ligjore si dhe për të sqaruar çdo situatë apo paqartësi që ata kanë në raport me institucionet apo me kuadrin ligjor. Në vazhdim asistencë ligjore bëhet pjesë e programit të ndihmës për përfituesit dhe punohet për plotësimin e nevojave të tyre.

- Rastet e asistuar në gjykatë

19 përfituese të programit të D&E të cilat kanë patur procese gjyqësore kundër trafikanteve të tyre janë informuar vazhdimisht rreth çështjeve të tyre përmes takimeve direkte me prokurorët e çështjeve. Çështjet janë ndjekur pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda apo në Prokuroritë e Rretheve ku përfitueset kanë bërë denoncimin.

Përveç informimit dhe këshillimit ligjor gjatë vitit 2014 disa përfituese janë asistuar edhe për proceset gjyqësore, duke i përfaqësuar në gjykatë. Gjithsej janë **asistuar 5 përfituese** për proceset e tyre gjyqësore, kryesisht çështje civile që kanë të bëjnë me divorcin dhe pasojat që vijnë nga zgjidhja e martesës, caktimi i përgjegjësive prindërore, caktimi i detyrimit ushqimor, ndarja e pasurisë midis bashkëshortëve, etj. Dy përfituese janë përfaqësuar në gjykatë nga avokatët e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Për një rast tjetër kemi patur bashkëpunim

edhe me qendrën ARSIS për kryerjen e vleresimit nga ana e psikologut. Tre raste janë përfaqësuar në gjykatë nga juristi i qendrës D&E (2 në Tiranë dhe 1 në Fier).

Përfitueset janë asistuar edhe për praktika dhe procedura që kanë të bëjnë me sigruimin e dokumentacionit apo për aplikime të ndryshme për shërbime apo veprime nëpër institucione. Për një nga përfitueset është marrë informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për të konfirmuar regjistrimin e dy fëmijëve të saj, të cilët janë strehuar bashkë me përfituesen në qendrën e D&E. Një përfituese e huaj është asistuar për të siguruar lejen e përkohshme të qëndrimit dhe më pas rinovimin e saj.

1 përfituese e D&E ka aplikuar për pajisjen me kartë identiteti dhe dy të tjera janë në process për të aplikuar. D&E ka negociuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me qëllim mundësimin e aplikimit për Karta Identiteti në Tiranë të të gjitha përfitueseve që për arsye sigurie nuk mund të aplikojnë në vendin e tyre. D&E ka bashkëpunuar gjithashtu me Njësinë Bashkiake të zonës ku ndodhet strehëza. Për pajisjen e përfitueseve me certifikata lindje e familjare është bashkëpunuar me Drejtorinë e Policisë të zonave nga vijnë rastet.

- Zhvillimi i temave ligjore

Gjatë vitit 2014 janë zhvilluar rregullisht takime në grup me përfituesit për të trajtuar tema të ndryshme ligjore. Këto seanca kanë shërbyer për të informuar dhe këshilluar përfitueset për tema dhe situata të ndryshme ligjore. Temat e përzgjedhura janë të lidhura me probleme që shqetësojnë në praktikë përfitueset, por edhe informuese për kuadrin ligjor dhe procedura të ndryshme. Temat ligjore të organizuara me përfitueset çdo ditë të enjte të javës janë si më poshtë:

- Kuadri ligjor që rregullon fushën e luftës kundër trafikimit, në veçanti dispozitat e Kodit Penal që dënojnë trafikimin e personave;
- Të drejtat e njeriut duke u fokusuar tek të drejtat themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligje të tjera;
- Të drejtat e fëmijëve parë në kontekstin e ligjit të 2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Kuadri ligjor që rregullon fushën e regjistrimit në gjendjen civile (regjistrimi I lindjeve, transferimi I dokumentacionit, elemente që kanë të bëjnë me të dhëna të tjera të regjistrimit të gjendjes civile);
- Tema të lira për familjen dhe të drejtën familjare (familja si koncept ligjor, martesë, zgjidhja e martesës, pjesëtimi i pasurisë pas martesës, caktimi i kujdestarise, detyrimi ushqimor, biresimi etj);
- Diskutime të tjera të lira sipas kërkesave të përfitueseve.

Trajnime për punësim, kurse profesionale

Ne total **21 përfitues kanë ndjekur kurse profesionale**. Disa përfitues kanë ndjekur me shumë se një kurs, bazuar në aftësitë dhe dëshirat individuale.

Kurse profesionale / Trajnime profesionale

Nr	Kurse	Ofruar	Nr. i rasteve
----	-------	--------	---------------

1.	Italisht	Qendra e formimit profesional Vullnetare D&E	2 5
2.	Receptionist	Qendra e formimit profesional	1
3.	Estetikë	Qendra e formimit profesional	1
4.	Kuzhinë	Qendra e formimit profesional	2
5.	Rrobaqepsi	Qendra e formimit profesional	1
6.	Travel agency course (Amadeus program)	Agjensi Private Udhëtimesh	1
7.	Kurs mobilerie	Qendra e formimit profesional	1
8.	Kurs kompjuteri	Qendra e Edukimit D&E	17
9.	Anglisht	Vullnetare D&E Qender e Gjuheve te huaja Durres	11 1
10.	Kurs kitare	Qendra e Edukimit D&E	17
11.	Babysitter	Qendra e formimit profesional	1
12.	Kurs gjermanisht	Qendra e Kurseve Univers	1
13.	Kurs Stilimi	Sallon Atelie privat	1

Edhe gjatë kësaj periudhe trajnimet dhe aktivitetet edukuese për përfitueset e D&E në Qendrën e Edukimit kanë qënë thelbësore. Për të rritur aftësitë për jetën të përfitueseve, stafi i D&E ka organizuar aktivitete të ndryshme, trajnime për çështje të ndryshme, diskutime në grup, leximi i librave artistik, mësimi i materialeve shkollore si dhe i materialeve të kurseve ku ato marrin pjesë.

Trajnimi për ndihmën e parë është ofruar për përfitueset e D&E. Trajnimi u prezantua nga një pediatër, janë zhvilluar 7 seanca, për periudhën *2 Prill – 21 Maj 2014*. 8 përfituese kanë marr pjesë rregullisht në trajnim. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte të përgatisë nënat e reja për kujdesin ndaj fëmijëve për situatat emergjente në rastet e një temperature të lart, helmim, djegje, dhimbje stomaku, enjtje. Trajnimi ishte i rëndësishëm jo vetëm për përfitueset nëna të fazës së dytë të programit por edhe për përgatitjen e përfitueseve të akomoduar në qendrën e riintegrimit.

Edukim dhe shkollim

Gjatë vitit 2014 puna e bërë me përfitueset e programit në fushëm e edukimit ka konsistuar kryesisht në regjistrimin e tyre në shkollat përkatëse, sipas nivelit të shkollimit të mëparshëm. Mbështetje u është dhënë përfitueseve të akomoduar në qender, duke punuar për të zbutur sadopak mangësitë në formimin e përgjithshëm të tyre, po edhe në dijet e fushave të ndryshme.

Për rastet e reja të hyra në program është bërë nga mësuesja e D&E një vlerësim për përcaktimin e nivelit arsimor të cdo përfitueseje dhe më pas është zhvilluar një plan edukativo-mësimor si pjesë e planit të riintegrimit të cdo përfitueseje.

11 raste dhe 33 fëmijë të tyre kanë ndjekur gjatë kësaj periudhe shkollën. Përfitueset janë ndihmuar rregullisht nga mësuesja e D&E për t'u përgatitur, vecanerisht për lëndët ku ato kanë pasur boshllëqe nga e kaluara. Të gjitha përfitueseve ju janë siguruar librat si edhe mjetet e tjera shkollore të nevojshme për një vijueshmëri sa më të mirë akademike.

Për 2 raste të akomoduar në Qendrën e Riintegrimit të cilat nuk kanë ndjekur asnjë klasë shkollë është punuar personalisht me secilën prej tyre kryesisht në shkrim, lexim, matematikë, etj.

- Tema të diskutuara:

Sesione informuese të ndryshme janë organizuar nga mësuesja e D&E lidhur me çështje të ndryshme si më poshtë:

- BE dhe anëtarët
 - Tërmetet
 - Stinët dhe ekuinoksi
 - Veshjet e përshtatshme për raste të ndryshme
 - Si të bëjmë një lajmërim, një kronikë, si të bëjmë një ankesë, një kërkesë, një ftesë
- a) *Tema mesimore:*
- Si ta kuptojmë përmbajtjen e një shkrimi, si ta themi në vetën e tretë;
 - Mbledhje, zbritje me numra dy-tre shifrorë;
 - Si bëhet projekti i një apartamenti;
- b) *Tema zëhavitëse:*
- Gjëgjëza problemore,
 - ushtrime sugjestionuese,
 - imitime të aktorëve të humorit,
 - puzzel etj.
- c) *Njgjarje historike:*
- 17 Janari – Vdekja e Skënderbeut
 - 17 Shkurti- Pavarësia e Kosovës
 - Kongresi i Lushnjës
 - 7 Marsi- Dita e Mësuesit
 - 8 Marsi – Dita Ndërkombëtare e Grave
 - 1 Maji – Dita e Punëtorëve
 - 5 Maji – Dita e Dëshmorëve
 - 1 Qershori- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
 - 18 – Tetori - Lumturimi i Nënë Terezës
 - 28- Nëntori – 102 vjetri i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë
 - 29- Nëntori - 70- Vjetori i Çlirimit të Atdheut
- d) *Aktivitete argetuese, relaksuese te organizuara*
- 14-Shkurti (San Valentini)
 - 7-8 Marsi
 - 102 vjetori i Pavarësië
 - 70-vjetori i Çlirimit të Shqipërisë
 - Festime të ditëlindjeve të përfitueseve dhe të fëmijëve
 - Biseda të lira në lidhje me jetën në shelter
 - Komunikimi i bukur-çelësi i suksesit

D&E ka bashkëpunuar me institucione shtetërore, organizata partnere për problemet e shkollimit të përfitueseve. Një përfituese është mbështetur për t'u regjistruar në shkollë private për shkak të problemeve të sigurisë. Përfituesja është pajisur me mjetet e nevojshme shkollore,

cante shkolle, etj. Një përfituese tjetër e cila ka ndërprerë masterin për shkak të mungesës së mundësive për të paguar tarifën e univeritetit është referuar nga D&E pranë organizatës “Assistance for Community” në Shqipëri, e cila ka marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve të Masterit dhe shpenzime të tjera të lidhura me mbarëvajtjen shkollore të përfitueses. Është bashkëpunuar gjithashtu me drejtuesit e shkollave “Lidhja e Prizërenit” dhe “Kostandin Kristoforidhi”, por dhe me Drejtorinë Rajonale të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit për regjistrimin e përfitueseve dhe mbarëvajtjen e tyre pranë këtyre shkollave.

Ndërmjetësim me familjen

Menaxherët e rasteve kanë organizuar seanca këshillimi jo vetëm për rastet e akomoduar në qendër por gjithashtu për prindërit e tyre, motrat e vëllezërit.

- 36 përfituese janë asistuar në familjet e origjinës.
- 14 raste të hyra në program gjatë kësaj periudhe janë asistuar direkt në familje.
- 8 përfituese janë bashkuar me familjet e tyre gjatë kësaj periudhe dhe vazhdojnë të ndihmohen nga D&E.
- Shumica e rasteve të akomoduar në RC janë mbështetur nga stafi D&E në stabilizimin e marrëdhënieve me familjet e tyre.
- Rastet shoqërohen në takime me familjarët nga punonjëset sociale dhe psikologjia në Tiranë e gjithashtu janë shoqëruar për tu takuar me të afërmit në qytetet apo fshatrat ku ata banojnë si Kucova, Shkodra, Lezhe, Durres, Vlora, Fier, Berat, Elbasan, Korce, etj.
- Është bashkëpunuar me policinë për vendosjet e kontakteve me familjen si dhe në organizimin e takimeve pranë ambienteve të Drejtorisë së Policisë veçanërisht për përfitueset të cilat kanë patur probleme sigurie.
- Realizohen vazhdimisht telefonata me familjarët.

A. gjate kohes së qendrimit të saj në qendër ka patur shumë mosmarrëveshje dhe konflikte me familjen për shkak se ato nuk mund ta pranonin se çfarë asaj i kishte ndodhur duke e fajësuar për të gjitha ndodhitë. Familja për një kohë të gjatë nuk pranonte ta takonte atë. Reagimi i tyre kryesisht i së ëmës ishte shumë refuzues ndaj së bijës. Ato nuk dëshironin që ajo të kthehej në familje e për më tepër në qytetin ku ato jetonin. Një nga synimet e arritura ka qenë pikërisht ndërmjetësimi me familjen dhe rivendosja e kontakteve me ato. Pas shumë bisedave telefonike me prindërit e saj ata arritën të kuptojnë situatën dhe filluan të përkrahin e mbështesin vajzën e tyre. Pas gati 1 vit qëndrimi në qendër, A. u kthye në familje dhe vazhdon të mbështetet dhe atje.

Aktivitetet social - kulturore

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa aktivitete sociale për përfitueset.. Aktivitetet janë organizuar si brenda dhe jashtë qendrës.

- Aktivitetet e organizuara brenda shelterit kane qenë:

➤ *diskutime grupi* me tema te ndryshme;

Me shumë interes janë ndjekur diskutime rreth **dhunës në familje**, ku jo vetëm është dhënë informacion, por vajzat kanë ndarë dhe eksperincat e tyre rreth këtij problem, mbi format e dhunës, karakteristikat e grave të abuzuara dhe karakteristikat e burrave dhunues, pasojat e dhunës në familje tek gratë dhe fëmijet, cikli i dhunës, etj. Gjithashtu u është dhënë informacion

mbi Ligjin për parandalimin e dhunës në familje: Urdhërin e Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe Urdhërin e Mbrojtjes.

Gjithashtu janë zhvilluar dhe diskutime në grup apo biseda të lira sipas situatave të caktuara rreth **menaxhimit të stresit, zemërimit**. Probleme të **komunikimit në marrëdhëniet ndërpersonale** duke patur si objektiv modelimin e sjelljes, fjalorit etj.

- *festimi i festave të ndryshme;*
- *festimi i ditëlindjeve të përfitueseve;*
- *workshopet e kuzhinës* nëpërmjet të cilave përfitueset mësojnë të gatujnë receta të ndryshme; *kinamaja* e organizuar në shelter (DVD të siguruar nga D&E) ku përfitueset kanë parë filma të ndryshëm argëtues;
- *lojra të ndryshme argëtuese, energjike;*
- *përgatitja e punëve të dore, qëndisje;*
- *mbrëmje muzikore* të organizuara çdo të shtunë;
- *leximi i librave* të ndryshëm nga biblioteka e D&E;
- *kinema* në shtëpi;
- *lojra energjike.*

- Aktivitete jashtë shelterit:

Janë organizuar një sërë aktivitete edhe jashtë strehëzës me karakter zbavitës por dhe informues. Kështu disa aktivitete të organizuara janë:

- vizitë në Malin e Dajtit pranë qytetit të Tiranës;
- vizitë në kështjellën e Preza-së;
- koktej në një bar për ditën e San Valentinit dhe Ditën e Gruas;
- piknik në liqenin artificial të Tiranës;
- vajtja në Kishën e Laçit;
- vizitë në amfiteatrin e Durrësit;
- vajtja e nënave me fëmijë në kënde lojrash apo lokale me lojra për fëmijët e tyre;
- vajtja në plazh/ pishina 10 dite në verë
- vizitë në panairin e Krishtlindjeve.

Asistencë për fëmijët e përfitueseve

Gjatë kësaj periudhe janë asistuar në programin e D&E 60 fëmijë të shoqëruar me nënat e tyre nga ku 11 fëmijë janë ndihmuar në Qendrën e Riintegritimit dhe 49 janë asistuar bashkë me nënat në fazën e dytë të programit.

- 5 fëmijë të përfitueseve kanë shkuar rregullisht në cerdhe;
- 7 fëmijë të përfitueseve kanë shkuar rregullisht në kopësht;
- 33 fëmijë kanë ndjekur rregullisht shkollën; gjatë vitit të ri shkollor fëmijët janë pajisur me librat dhe mjetet shkollore, canta shkolle si dhe veshje;
- Të gjithë fëmijët kanë bërë vaksinat në bazë të skemës së vaksinimit dhe janë ndjekur rregullisht nga pediatri;
- 5 fëmijë të përfitueseve u mbështetën për të marrë pjesë për dy javë në një kamp veror;
- Gjatë festave të fundvitit për fëmijët janë shpërndarë dhurata.

D&E ka bashkëpunuar me Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të fëmijëve për regjistrimin e fëmijëve në kopësht dhe cerdhe.

Ndihmë financiare dhe afatgjatë

- 86 raste dhe 56 fëmijë janë asistuar me shërbime në komunitet në fazën e dytë dhe të tretë të programit të riintegritit gjatë kësaj periudhe.
- Nga këto, 44 raste dhe 34 fëmijë janë ndihmuar në apartamente, 36 raste dhe 20 fëmijë janë të mbështetur në familjet e tyre, 5 përfituese dhe 2 femije janë asistuar në vende të tjera alternative.
- 15 përfituese të reja dhe 13 fëmijë të tyre kanë hyrë në program duke u ndihmuar direkt në apartament dhe 14 përfitues dhe 12 fëmijë të tyre kanë hyrë në program duke u ndihmuar direkt në familje; 1 rast është asistuar direkt në vend tjetër alternativ (në konvikt);
- D&E ka mbështetur 31 përfitues financiarisht me mbulimin e qerasë së apartamenteve në fazën e dytë të programit të riintegritit të konsideruar si shumë të rëndësishëm në procesin e fuqizimit të përfituesve dhe në drejtim të riintegritit të suksesshëm në shoqërinë shqiptare.

Informacion mbi shërbimet në komunitet

Menaxherët e rasteve të D&E sigurojnë mbështetje të vazhdueshme për rastet që ndihmohen në fazën e dytë dhe fazën e tretë të riintegritit, duke ju ofruar informacionin e nevojshëm për shërbimet ekzistente që ofrohen në komunitet.

Një hartë e shërbimeve në komunitet është përgatitur dhe u është shpërndarë përfituesve, edhe pse ato shoqërohen nga menaxherët e tyre për të njohur vendet dhe adresat e këtyre shërbimeve. Përfitueset informohen për të drejtën e përfitimit të asistencës ekonomike si VeT, dhe mbështeten për të plotësuar dokumentat e nevojshme.

Gjithashtu përfitueset janë informuar për shërbimet që ofrohen dhe në bashkëpunim me ZRSHSSH, ndërmjetesimi nga ana e tyre për marrjen e shërbimeve si dhe monitorimi nga punonjësit e ZRSHSSH në qytete të ndryshme ku rastet janë asistuar.

Informacion është ofruar lidhur me shërbimet që ofrohen edhe nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Përfitueset të cilat janë në fazën e dytë e të tretë të programit janë informuar nga doktori i D&E rreth procedurave për të përfituar shërbime shëndetësore falas në institucione shëndetësore shtetërore si dhe për të përgatitur dokumentat e duhur shëndetësor në vendet e tyre të origjinës dhe transferimi i këtyre dokumentave tek mjeku i familjes në Tiranë.

Monitorimi dhe ndjekja e rasteve

Përfitueset e fazës së dytë e të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet të përmendura më lart bazuar në nevojat e tyre.

Monitorimi i përfituesve vazhdon të kryhet me anë të takimeve direkte, ashtu edhe me anë të kontakteve të rregullta me telefon. **86 përfituese janë monitoruar gjatë kësaj periudhe.**

Sesione të rregullta këshillimi janë ofruar nga psikologjia e D&E për përfituesit në program, të cilët janë aktualisht në fazën e dytë të riintegritit. Kontakte të rregullta përfituesit e fazës së dytë të programit të riintegritit kanë edhe me menaxherët e rasteve. Gjatë kësaj periudhe stafi ka monitoruar dhe ka bërë takime direkte me përfitueset të cilat jetojnë në qytetet e tyre të origjinës si Durrësi, Berati, Kucove, Vlora, Elbasan, Korce, Lezha, dhe Shkoder.

b. KONTRIBUTI NË KTHIMIN E ASISTUAR TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT APO VMT

D&E në bashkëpunim me Autoritetin Përgjegjës dhe me organizata të tjera ka sistuar në kthimin vullnetar të asistuar të 5 rasteve VT/VMT

D&E ka bashkëpunuar me tre organizata jashtë Shqipërisë, **nje në Angli dhe 2 në Gjermani**, për kthimin, mbështetjen dhe ofrimin e asistencës në vendin e origjinës për dy raste që me informacionin e dërguar nga organizatat respektive rezultojnë të shfrytëzuara apo VMT.

Organizata e pare është **“Sisters of our Lady of Charity Redcote Convent”** në Angli dhe organizata tjetër e cila referoi 2 raste është **“SOLWODI”** organizatë në Gjermani. Te treja rastet janë mbështetur në familje dhe kanë marrë të gjithë ndihmen për të cilën kanë patur nevojë.

D&E ka vazhduar gjithashtu bashkëpunimin me organizatën në Spanjë **“SICAR cat Serveis”** ku po asistohet një tjetër vajzë shqiptare, viktimë trafikimi e shfrytëzuar për qëllime seksuale e cila kërkonte të lidhej me fëmijët e saj që jetonin në Tiranë dhe të bëhej një vlerësim për ta pasi ajo mendonte se fëmijët shfrytëzoheshin për lypje.

Për kthimin dhe asistimin e rasteve është bashkëpunuar me anëtarët e Autoritetit Përgjegjës duke u informuar që në fillim, përpara kthimit të shtetaseve nga Gjermania dhe Anglia. Për pritjen e rasteve (të kthyerat me avion në aeroportin e Rinasit) u angazhuan strukturat përgjegjëse si specialistët të Zyrës Anti-trafik Tiranë si dhe punonjësit social të Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Tiranë si dhe gjithashtu përfaqësuesi i D&E.

Gjatë vitit 2014 dy raste të huaja, përfituese të programit të D&E të akomoduar në strehëz janë mbështetur për kthimin e tyre në vendin e origjinës. Për të dyja rastet është bashkëpunuar me IOM për sigurimin e dokumentave të nevojshme për udhëtimin e tyre, krijimin e lehtësirave dhe mbështetjen e tyre gjatë udhëtimit sidomos në vendet tranzit si dhe mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit. Përveç kësaj IOM ka akorduar dhe një grant për të dyja rastet me qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e tyre në vendin e origjinës sipas një plani paraprak të bërë me përfitueset. Për kthimin e të dyja rasteve është bashkëpunuar dhe me Autoritetin Përgjegjës.

c. ASISTENCË DIREKTE PËR MESHKUJ VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

Gjatë kësaj periudhe D&E ka ndihmuar 18 meshkuj viktime /viktime të mundshme të trafikimit nga të cilët 10 meshkuj viktime / viktime të mundshme të trafikimit ishin raste të reja të referuar pranë programit riintegruar të D&E. Në bashkëpunim me menaxherin e rasteve të D&E, një plan riintegrimi është ndërtuar për secilin rast dhe janë mbështetur për të arritur objektivat e vënë në plan.

Rastet meshkuj VT e VMT janë mbështetur me këshillim psiko-social, ndihmë ligjore, asistencë mjekësore, mbështetje për të gjetur një punë, mbështetja financiare për pagesën e apartamentit me qira; trajnimi për të rritur aftësitë për jetën; ofrimi i informacionit dhe ndërmjetësimi për marrjen e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të ndryshme në komunitet,

monitorimit dhe ndjekja e rastit, etj. Psikologu i D&E ka ofruar seanca të rregullta këshillimi individual për të gjithë përfituesit meshkuj në program.

Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve problem i rëndësishëm vazhdon të mbetet strehimi. Gjatë vitit 2014, 15 raste kanë patur nevojë për strehim dhe janë mbështetur nga D&E me gjetjen dhe mbulimin e shpenzimit të qerasë së apartamentit. Kjo tregon që strehimi mbetet një ndër nevojat më bazike të meshkujve viktime trafikimi apo viktime të mundshme trafikimi të asistuar deri tani, ashtu sikurse duket që varfëria vazhdon të mbetet një ndër faktorët kryesorë që meshkujt e rinj të moshës 15-22 vjeç të bien pre e shfrytëzimeve të llojeve të ndryshme.

Një rëndësi e veçantë gjatë procesit të ri-integritit, ka punësimi i qëndrueshëm i rasteve. Gjatë këtij viti rastet janë ndihmuar me ndërmjetësim për punësim apo fuqizim ekonomik. Gjashtë raste kanë ndjekur trajnimin "Këshillim për Punësim". Pas mbarimit të trajnimit, dy nga rastet kanë blerë motocikleta dhe i kanë perdorur në punën e tyre të përditshme. Për një rast është ndërmjetësuar për të punuar 4-8 orë në javë pranë YAPS, biznes social në mënyrë që të mbulojë shpenzimet e tij të përditshme dhe një rast është ndihmuar me një grant të vogël për fuqizim ekonomik. Një rast tjetër për shkak të aftësisë së kufizuar fizike merr pagesë invaliditeti. Tre raste kanë ndjekur shkollën. Kurset të cilat rastet meshkuj kanë ndjekur kanë qenë: kurs zdrukhtari; Italisht, Anglisht, etj.

Duke pasur parasysh përmbushjen e nevojave sociale të rasteve, një ndër mundësitë konkrete që ndihmon në përmbushjen e këtyre nevojave janë edhe kurset e ndryshme që fokusohen në hobet e tyre (pa qenë domosdoshmërisht profesion për ta). Nga ajo çfarë është parë, kjo është sidomos e rëndësishme për target grupin 16-18 vjeç, pasi të tilla aktivitete rrisin vetw-vlerësimin e tyre, rrisin aftësitë sociale dhe shërbejnë si një shpenzim kohe i shëndetshëm, përkundrejt aktiviteteve të dëmshme që kanë mësuar gjatë kohës që kanë qenë në situatë rruge si luajtja e pakontrolluar e lojërave të fatit, konsumimi i duhanit apo i drogërave të tjera, frekuentimi i rretheve shoqërore të dëmshme etj. Në këtë vazhdë 1 prej përfituesve është ndihmuar me materiale për të filluar një kurs pikturë, një rast tjetër është rregjistruar gjatë verës në aktivitetin futbollistik Milan Junior Camp, ndërsa një përfitues tjetër po pret të fillojë një kurs taekendo. Të tre përfituesit kanë qenë midis moshave 16-18 vjeç dhe ndihen shumë të kënaqur me aktivitetet. Kjo i ka ndihmuar ata të krijojnë një rrjet shoqëror të shëndetshëm duke u larguar nga situata dhe sjellje të rrezikshme. Gjithashtu ka patur impakt edhe në mirëqenien psikologjike dhe në rritjen e aftësive për të përballuar situata të ndryshme.

Një ndër sfidat kryesore që mbetet lidhur me punësimin e meshkujve të trafikuar është fakti që shumica e rasteve kanë nivele të ulta edukimi dhe përvojë shumë të pakët pune. Kjo e bën procesin e rintegritit dhe të qëndrueshmërisë në punë të vështirë për disa përfitues. Shpesh, ata duhet të provojnë 2-3 punë të ndryshme derisa të gjejnë veten në një punë të caktuar.

d. RRIJTJA E PËRPIEKJEVE PËR IDENTIFIKIMIN E VeT

Edhe gjatë këtij viti D&E është fokusuar shumë për identifikimin e viktimeve të mundshme të trafikimit përmes organizimit të punës në terren dhe si rezultat Njësia Lëvizëse ka identifikuar **17 viktime të mundshme trafikimi.**

Aktivite të Njesisë Lëvizëse:

Gjatë vitit 2014 Njësia Lëvizëse ka realizuar një sërë aktivitetesh si më poshtë:

- **Kontakte direkte** me personat të cilët vijnë nga familje apo grupe vulnerabël në zonat problematike të qytetit të Tiranës.

Gjatë kësaj periudhe janë kontaktuar në mënyrë direkte 620 njerëz nga komuniteti, ku një pjesë e tyre janë ndihmuar që të marrin shërbimet përkatëse që j'u nevojiteshin. Konkretisht janë ndihmuar 47 raste.

Shërbimet e ofruara	Regjistrim tek zyra e punës si punëkërkuar i papunë si dhe ndihmë në gjetjen e punës	Regjistrim për kurse profesionale tek Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional	Referim tek CPU-të ose organizatat partnere për shërbimet përkatëse
Numri i rasteve ose përfituesve	20 raste	12 raste	15 raste

- **Realizimi i fokus grupeve** me pjesëtarët e këtyre komuniteteve në nevojë duke diskutuar tema lidhur me trafikimin dhe shfrytëzimin e personave, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe për të identifikuar viktimat e mundshme të trafikimit.

Një sërë fokus grupesh janë realizuar edhe në shkollat e mesme të Tiranës nëpërmjet shfaqjes së Fotonovelës e cila është pëlqyer shumë nga të rinjtë.

Gjatë kësaj periudhe D&E ka qenë i përfshirë në veprimet e ndërmarra nga Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve duke iu referuar fëmijëve në situatë rruge. Njësia Lëvizëse e D&E ka punuar në zonat e Njesisë Bashkiake nr. 1, 2, 3, 4, 7 dhe 11. Në kuadër të zbatimit të planit të Tiranës për fëmijët në situatë rruge, D&E ka asistuar Bërthamën e ngritur për këtë nismë nga Shërbimi Social Shtetërorë dhe Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. D&E ka mbështetur këtë bërthamë duke mbuluar punën në terren gjatë fundjavave dhe gjatë dy mbasditeve përgjatë ditëve të javës. Gjatë punës në terren, janë referuar tek Bërthama shumë të mitur të cilët gjendeshin të shoqëruar nga prindërit apo të vetëm, duke lypur apo duke shitur. Gjithashtu D&E ka ofruar ekspertizën e saj për raste të cilat është dyshuar se shfrytëzohen apo trafikohen. Gjatë vitit 2014, punonjësit e D&E kanë marrë pjesë në 4 tryeza teknike ku është diskutuar për raste të ndryshme.

Një punonjës i D&E ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar për protokollin e ndërhyrjes për fëmijët në situatë rruge.

Gjatë këtij viti Njësia Lëvizëse ka identifikuar **17 viktimat të mundshme trafikimi** të raportuara të gjitha tek Autoriteti Përgjegjës. Nga këto 3 raste janë futur në programin riintegruar të D&E, 2 raste kanë refuzuar të ndihmohen, 3 raste ndodhen jashtë kufijëve të Shqipërisë dhe është bashkëpunuar me Policinë e Tiranës për zgjidhjen e tyre, kurse pjesa tjetër janë referuar për ndihmë tek organizatat partnere dhe CPU-të përkatëse.

Gjinia	Lloji i shfrytëzimit	Të rritur/minoren
14 Femra 3 Meshkuj	13 - Shfrytëzim seksual 1 - Shfrytëzim për punë 3 - Shfrytëzim për krime të lehta	10 Minoren 7 të Rritur

- **Trajnime stafi** me institucione për ngritje kapacitetesh në lidhje me identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit.

Gjatë këtij viti janë realizuar disa *trajnime stafi* me institucione dhe organizata partnere për ngritje kapacitetesh në lidhje me identifikimin dhe referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit.

Gjatë vitit 2014 dhe vitit paraardhës, njësia lëvizëse ka realizuar dhe disa trajnime me organizatat partnere si Aksion Plus, ADRA, SHKEJ-in dhe World Vision-Zyra e Tiranës me qëllim rritjen e kapacitetit të stafit në lidhje me çështjet e trafikimit.

e. RRIJTJA E PËRPPJEKJEVE PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Këshillim dhe mbështetje për punësimin e përfitueseve

Gjatë këtij viti 33 përfituese kanë qënë në marrëdhënie pune si: rrobaqepse, kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, pjatararë në restorant, pastruese, ndihmëse parukiere në sallon parukerie, operatore në call center, banakiere, shpërndarës ushqimesh, pasticiere, kamarier, punonjës mobilerie, punonjese marketi, shitëse peshku, etj.

Stafi i D&E vazhdon të orientojë përfituesit të zgjedhin profesione të kërkuara në tregun e punës, duke u përshtatur natyrisht në çdo rast me aftësitë e tyre personale.

10 përfitues të programit të riintegritimit të D&E kanë qënë të përfshirë në ciklin Këshillues "Këshillim për punësim". Qëllimi i këtij cikli këshillues është për të ndihmuar ata për të rritur aftësitë e tyre në gjetjen dhe mbajtjen e një pune. Përmes këtij programi, përfituesit janë mbështetur për të ndjekur kurse profesionale, trajnime në vende pune, për të qënë pjesë e programeve të stazhit pranë kompanive të ndryshme private dhe mundësi për të hapur mikro-biznese.

Trajneri i ciklit këshillues ka punuar me grupet përkatëse për të krijuar ekupe të konsoliduara, për të identifikuar pikat e forta personale të secilit përfitues, duke synuar në afat të gjatë për të rritur aftësitë dhe aftësitë e tyre në gjetjen dhe mbajtjen e një pune; iniciativat inkurajuese dhe aftësitë hulumtuese të pjesëmarrësve; zhvillimi i kompetencave sociale të grupit; marrja e njohurive dhe përgatitje për stazhe afatshkurtra. Pjesëmarrësit në trajnim janë njohur me profesione dhe biznese të reja, duke u përgatitur për një përfshirje të mundshme në praktika të afatshkurtra dhe afatgjata pranë këtyre bizneseve.

D&E vazhdon të ketë kontakte të rregullta me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe të gjithë përfituesit që janë tashmë gati për të punuar janë regjistruar pranë këtij institucioni si punëkërkuar.

Mbështetja e përfituesve për hapjen e bizneseve të vogla

Gjatë kësaj periudhe **13 përfitues të D&E kanë menaxhuar bizneset e tyre**. Biznesi i fundit i hapur është një rrobaqepsi e vogël për një nga përfitueset e programit. Janë siguruar materialet e nevojme për hapjen e biznesit si makinë qepëse, copa, etj. Përfituesja ka përfunduar një kurs rrobaqepsie dhe vetëpunësimi i saj është konsideruar mundësia më e mirë për të duke qenë se ka dhe dy fëmijë të vegjël.

Përfituesit janë monitoruar rregullisht dhe mbështetje teknike është siguruar për ta sipas nevojave të tyre.

Programi i internship-it me kompanitë e biznesit

Gjatë këtij viti 4 nga përfituesit që kanë ndjekur “Ciklin e Këshillimit drejt Punësimit” janë përfshirë në programe intershipi: dy përfitues janë përfshirë në një biznes social, një vajzë është përfshirë si asistente kuzhinierë dhe një përfitues si shpërndarës ushqimesh.

Ndërkohë një përfituese është përfshirë si ndihmëse kuzhinierë pranë restoranti prestigjioz në Tiranë dhe një përfituese tjetër si asistente zyre pranë një shoqate të krishtere.

Punësimi i përfituesve pranë organizatës së D&E

Dy përfituese kanë vazhduar të punojnë pranë organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, njëra në pozicionin e magazinieres dhe tjetra në pozicionin e sanitares.

f. AVANCIMI I BASHKËPUNIMIT ME OFRUESIT E SHËRBIMIT DHE ME INSTITUCIONET SHTETËRORE LOKALE

Në mënyrë që të sigurojë një paketë të plotë shërbimesh riintegruese, D&E vazhdon të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë dhe ofrues të tjerë të shërbimeve në komunitet.

Kështu D&E ka bashkëpunuar me **SHKBSH** dhe **Krahët e Shqiponjës** për identifikimin e vendeve të përshtatshme alternative për minorënët, viktimat e trafikimit të cilat kanë humbur përkujdesjen e prindërve; **Ndihmë për Jetën** për referimin dhe mbështetjen e rasteve viktimat trafikimi me probleme të shëndetit mendor; **Zyrat Rajonale të Punësimit; ARSIS; CARITAS Albania;** qendra ligjore **TLAS** dhe **QNLQ** për ofrimin e shërbimit ligjor falas për viktimat e trafikimit apo persona të tjerë në nevojë; qendra **“Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”;** **“Qendra për Popullsi dhe Zhvillim”** e cila ka ofruar shërbime shëndetësore për grupin e viktimave të trafikimit; **Qendra e Formimit Profesional** për ofrimin e trajnimeve e kurseve të ndryshme profesionale për VT e VMT, Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror në Lezhë përveç se si burim referimi edhe monitorimi të rasteve VT e VMT.

Në kuadër të punës së Njësisë Lëvizëse, janë hartuar marrveshje midis D&E dhe organizatave jo fitimprurëse e institucione shtetërore si: qendra ligjore **TLAS; Njësia Bashkiake nr 1 dhe Njësia Bashkiake nr 2; Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**. Qëllimi i këtij

bashkëpunimi është jo vetëm identifikimi dhe referimi i viktimave të mundshme apo viktimave të trafikimit por edhe ofrimi i shërbimeve për grupe në nevojë.

D&E ne bashkëpunim me Fondacionin Mary Ward Loreto dhe Peace Corps Albania ka organizuar aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit me komunitete lokale dhe profesionistë lokalë në qytete e komuna të ndryshme të Shqipërisë nga veriu në jug.

g. AKTIVITETE NDËRGJEGJËSUESE PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI

Ashtu siç do vit D&E ka qënë aktive në organizimin e aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuese që synojnë të promovojnë dhe rrisin informacionin e shoqërisë shqiptare në lidhje me trafikimit, të drejtat e njeriut dhe në mënyrë të veçantë të drejtat e personave të shfrytëzuar, trafikuar dhe abuzuar. Për organizimin e këtyre aktiviteteve D&E ka bashkëpunuar ngushtësisht me **Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Anti –trafik, Ministrinë e Kulturës, Pedagogë, Psikologë te shkollave të Mesme etj.**

1. “Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit në Shqipëri -Ti japim fund stigmës”

Aktivitetet ndërgjegjësuese të ndërmarra nga D&E edhe gjatë vitit 2014 kanë synuar rritjen e respektimit të të drejtave të viktimave të trafikimit në shoqërinë shqiptare, duke synuar të luftojë stigmatizimin me të cilin viktimat e trafikimit përballën gjatë procesit të tyre të riintegrimin në shoqërinë shqiptare. Si mjet ndërgjegjësimi është përdorur fotonovela e prodhuar nga D&E.

Në këtë kuadër janë realizuar workshop-e me nxënësit e shkollave të mesme, forume me komunitetin, Workshop-e me punëdhënësit.

2. “Java Kombëtare Anti-trafik”

➤ Organizimi i Ekspozitës ndërgjegjësuese “Unë e lashë të kaluarën pas” me punime artistike të prodhuara nga viktimat e trafikimit.

Ky aktivitet u organizua nga D&E në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme /Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik dhe Ministrinë e Kulturës në ambjentet e të cilit u organizua dhe ekspozita. Punime të ndryshme arti të realizuara nga viktimat e trafikimit ishin të ekspozuara nëpërmjet të cilave u transmetuan dhe mesazhe ndërgjegjësuese mbi trafikimin dhe shpresën për të ardhmen. Pikturat u punuan gjatë sesioneve të Terapisë së Artit dhe çdo pikturë shoqërohej me nga një shprehje të shkruara nga vetë viktimat e trafikimit, në përpjekje për të sjellë me fjalë kuptimin e secilës nga pikturat. Disa nga temat e pikturave ishin : Vetja; Liria; Dashuria; Abuzimi Seksual; Shfrytëzimi; Skllavëria Viktima; E ardhmja, etj.

Gjatë pritjes, të ftuarit u informuan gjithashtu mbi situatën e viktimave shqiptare të trafikimit si dhe paten mundësi të jepnin kontributin e tyre në mbështetje të këtij target grupi. Në sallën Tefta Tashko Koco po pranë Ministrisë së Kulturës u shfaq edhe fotonovela **“Kjo është historia ime”** e bazuar në historinë e vërtetë të një viktime të trafikimit.

- **Forum i hapur** me studentët organizuar në Qytetin Studenti ku u diskutua për çështje lidhur me trafikimin;



- **Forume me nxënësit e shkollave të mesme të kryeqytetit;**



- **Shpërndarja e materialeve informuese dhe sensibilizuese lidhur me trafikimin;**



3. "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në familje"

- Në kuadër të punës për parandalimin e dhunës, këtë vit, organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" i ka dedikuar disa aktivitete fuqizimit të të rinjve që kanë qenë viktime të abuzimit seksual. Të paktën 8 raste janë angazhuar në aktivitete për përgatitjen dhe përfshirjen e tyre si këshillues të të rinjve për të dhënë kontribut në parandalimin e dhunës seksuale. Këshilluesit e të rinjve kanë prodhuar disa materiale ndërgjegjësuese, ndër to edhe artikulli **“Ne besojmë se mund ti japim fund shfrytëzimit seksual”** botuar në revistën elektronike të Terre Des Hommes.
- Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore (25 Nëntor – 10 Dhjetor 2014), stafi i organizates "Te Ndryshëm & Te Barabartë" organizoi në datën 5 Dhjetor 2014 një aktivitet ndërgjegjësuës me studentet e Fakultetit Gjeologji - Miniera. Slogani i aktivitetit ishte: “Djemtë dhe burrat, pjesë e zgjidhjes – Tregoni se jeni kundër dhunës!” Në fund të aktivitetit studentet u ftuan të jepnin mesazhe ndërgjegjësuese për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore në shoqërinë shqiptare.
- Diskutime me nxënësit e dy shkollave të mesme mbi dhunën në familje. Këto sesione informuese u organizuan në shkollën “Kristaq Rama” në Tiranë ku morën pjesë 20 nxënës dhe në shkollën “Elina” në Kamëz me pjesëmarrjen e 40 nxënësve.

4. Sensibilizim mbi çështjet e trafikimit të Qenieve Njerëzore

D&E në bashkëpunim me Fondacionin Mary Ward Loreto dhe Peace Corps Albania ka organizuar 35 aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimin me komunitete lokale, të rinj, nxënës, komunitetin rom dhe profesionistë lokal si, mësues, profesionistë të shëndetit publik, murgeshat e motrat e Nënë Terezës si dhe punonjës të OJF-ve në qytete e komuna të ndryshme të Shqipërisë nga veriu në jug.

905 pjesëmarrës kanë ndjekur këto aktivitete dhe janë informuar mbi çështje të ndryshme lidhur me trafikimin si: format e ndryshme të trafikimit, sfidat e riintegrimin të viktimave të trafikimit në komunitet dhe se si aktorët lokalë mund të mbështesin në riintegrimin e tyre. Si mjet ilustrues gjatë gjithë këtyre aktiviteteve u përdor dhe fotonovela.

	Pjesëmarrës Total	Femra	Meshkuj	Persona kyc	Studentë	Gra rome	Burra rome

	Vendi				P.Social	P. Bashkia	Punonjës të shëndetësisë	Mësues	Nxënës	Nxënëse		
1	Lezhe	25	1	24					24	1		
2	Maqellare	62	41	21				12	20	30		
3	Fan	44	23	21				1	21	22		
4	Vlora	18	10	8					8	10		
5	Permet	17	15	2		17						
6	Gjirokaster	28	23	5			28					
7	Durres	13	12	1	3						10	
8	Kucova	26	15	11			4		11	11		
9	Berat	23	22	1	5	10	6	2				
10	Korca	7	7				7					
11	Prenjas	10	4	6					6	4		
12	Bathore	48	48	0				2		46		
13	Raja `Dushaj	39	39					2		37		
14	Hot i Ri	18	18					1		17		
15	Jaro/Fier	10	10							10		
16	Cernica	35	29	6					6	29		
17	Kallmet	24	11	13					13	11		
18	Keneta/Durres	18	17	1				2	1	15		
19	Librazhd	8	5	3		3	5					
20	Maiminas	34	30	4				4	26	4		
21	Shkodra	18	14	4		6	4	8				
22	Gose	24	22	2			1	5	10	8		
23	Kavajes	8	2	6			2		6			
24	Fier	30	13	17					6	4	9	11
25	Durres	30	30							30		
26	Shkodra-shkolla	43	27	16					16	27		
27	Delvine	11	11							11		
28	Shkodra-shkolla	23		23					23			
29	Patos - bashkia	31	13	18		10	4	1	8	8		
30	Tamare	26	19	7				5	2	19		
31	Elbasan	14	9	5					5	9		
32	Tepelene	25	23	2			25					

33	Memelaj	44	30	14				5	14	25		
34	Libohove	59	37	22				3	22	34		
35	Tiranë	12	12				12					
	TOTAL	905	642	263	8	46	98	53	248	422	19	11

h. AKTIVITIETE PËR TË PARANDALUAR TRAFIKIMIN DHE PROMOVUAR MIGRACIONIN E SIGURT

Aktivitetet për të parandaluar trafikimin janë organizuar në vazhdimësi në kuadër të projektit: **“Vulnerabiliteti ndaj trafikimit dhe faktorët e riskut: Parandalimi i trafikimit dhe mbështetja e migracionit të sigurt në komunitetet e Shqipërisë, Bosnjës, Kosovës, Maqedonisë dhe Serbisë”** zbatuar nga D&E në bashkëpunim me FAFO Norvegji dhe NEXUS Institute Washington.

Qëllimi kryesor i projektit ishte adaptimi dhe vlerësimi i metodologjisë së deviancës pozitive (PD) për parandalimin e trafikimit dhe promovimin e migracionit të sigurt. Metodologjia e deviancës pozitive identifikon dhe mobilizon komunitetin duke synuar arritjen e ndryshimit social.

Projekti u realizua në një periudhë 2 vjeçare (2011 – 2013), i ndarë në dy faza: Faza 1 – Identifikimi i strategjive të deviancës pozitive; Faza 2 – Zbatimi i projektit.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme të projektit ishin:

1. Përgatitja e Manualit të Migrantëve (që përmban burime të rëndësishme informacioni në lidhje me: - shërbimet dhe burimet ekzistuese në Kucovë; informacion në lidhje me migracionin e sigurt dhe trafikimin; shërbimet dhe burimet në vendin e destinacionit Greqi; informacion bazik për migrantët e kthyer).
2. Organizimi i takimeve në komunitet me target –grupe individësh që konsiderohen vulnerabël ndaj migracionit të pasigurt dhe trafikimit. Gjithsej u organizuan 11 takime në komunitet, ku morrën pjesë një total prej 234 pjesëmarrësish.

Si faze finale e projektit në datat 19-20 Nëntor 2014 u organizua në Berat **Seminari Rajonal “Metodologjia e Deviancës Pozitive për të parandaluar trafikimin”**. Gjithsej në seminar morrën pjesë 19 pjesëmarrës nga Serbia, Maqedonia, Shqipëria, Bosnje – Hercegovina etj.



Në seminar u ndanë dhe diskutuan eksperiencat e organizatave partnere që zbatuan projektin në lidhje me përdorimin e kësaj metode për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore si edhe mundësia e replikimit të kësaj metodologjie në shtetet fqinje.


Për më shumë informacion në lidhje me zbatimin e projektit shikoni botimet e mëposhtme:

<https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/02/preventing-ht-pd-in-practice-brunovskis-surtees-2015.pdf>

<https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/02/reframing-trafficking-prevention-lessons-from-pd-approach-brunovskis-surtees-2015.pdf>

i. AKTIVITETE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS SEKSUALE

Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" organizoi dy workshop-e me 8 pjesëmarrës të rinj të cilët kanë qënë viktime të abuzimit seksual, si pjesë e projektit "**Zërat tanë**" udhëhequr nga Univeristeti "Bedfordshire" dhe mbështetur nga Këshilli Europës dhe OAK Foundation. Projekti "**Zërat tanë**" kishte për qëllim ndarjen e ideve mes të rinjve për parandalimin e dhunës seksuale në Europë. Në kuadër të këtij projekti u mbajt një sesion prezantues, ku u ftuan të merrnin pjesë përfituese të cilat po asistohen në fazën e ndryshme të programit. Pas sesionit prezantues, u mbajtën edhe dy workshop-e të cilat synonin që përmes ushtrimeve, teknikave indirekte dhe lojrave të ftonin të rinjtë të kontribuonin me idetë e tyre të cilat në një fazë tjetër mund të implementohen me qëllim parandalimin e dhunës seksuale në Europë. Këshilluesit e rinj kontribuan jo vetëm me idetë e tyre por edhe duke u përfshirë në përgatitjen e materialeve si poster (të cilin Univeristeti mund ta përdorë në aktivitetet e tij kundër dhunës seksuale) dhe një artikull kundër shfrytëzimit seksual me titull "**Ne besojmë se mund ti japim fund shfrytëzimit seksual**" i botuar në revistën elektronike të *Terres des Hommes*. Këshilluesit e rinj shprehën gadishmëri dhe entuziazmin për përfshirjen dhe vazhdimësinë e këtij projekti.



Në këtë fazë të parë të projektit, po punohet me gjetjen e mundësive se si të rinjtë tashmë, përveç se me idetë e tyre të kontribuojnë edhe me përfshirjen në projekte parandaluese.

Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" u ftua të merrte pjesë në Takimin e Parë të Grupit të Referimit dhe Shpërndarjes, mbajtur në Londër UK në 10 Dhjetor 2014. Qëllimi i këtij takimi ishte të ndante njohuritë dhe praktikat e mira në lidhje me promovimin e përfshirjes së të rinjve në përpjekjet për të parandaluar dhunën seksuale në Europë.



IV. TRAINIME DHE PREZANTIME TË OFRUARA NGA D&E

- ✚ D&E ka ofruar trainim për psikologët e shkollave të mesme të Tiranës mbi çështje të identifikimit dhe referimit të viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit. Trajnimi ishte realizuar në datën 2 Maj 2014 dhe ka pasur si pjesëmarrës 19 psikologë nga shkollat të mesme të Tiranës. Më tej me ndërmjetësimin e psikologëve të shkollave të cilët u trajnuan u realizuan fokus grupe me nxënësit në shkollat respektive, ku përveç dhe.
- ✚ D&E në bashkëpunim me Prefekturën e Tiranës ka organizuar trainimin “Identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit”. Pjesëmarrës në trainim ishin 40 profesionistë nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Administratore Social në rajonin e Tiranës. Trajnimi u realizua në datën 23 Qershor 2014 dhe kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të identifikuar viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.
- ✚ Me datën 20 Tetor 2014, organizata “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, në bashkëpunim me A.SH.R-në zhvilluan trajnimin me stafin shëndetësor. Ky trajnim u realizua në kuadër të projektit të Njësive të Lëvizshme me temë “Identifikimi dhe Referimi i Viktimave të Trafikimit”, me pjesëmarrës mjekë dhe infermierë të qendrave shëndetësore si dhe konvikteve të shkollave të mesme të qarkut Tiranë. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 38 mjekë dhe infermierë.



- ✚ Trainim mbi “Identifikimin dhe asistencën e VT e VMT”, është organizuar me 11 pjesëmarrës, duke përfshirë punonjës social, staf mjekësor dhe vullnetarë të organizatës “Aksion Plus” dhe Aleanca LGBT.
- ✚ Drejtoresha Ekzekutive e D&E është ftuar dhe ka bërë prezantim mbi “Përfshirjen Social Ekonomike të viktimave të trafikimit në Forumin e Grantdhënësve Lindor i organizuar në Palermo 8-10 Tetor 2014.
- ✚ D&E ka organizuar trainim për stafin e qendrës së re të hapur nga Aleanca LGBT mbi çështje të menaxhimit të rasteve, dokumentacioni i nevojshëm, përballja me raste të vështira, parimet etike, etj. Në këtë trainim morën pjesë 9 persona staf i qendrës.
- ✚ D&E ofroi prezantim për stafin e Ambasadës Amerikane mbi programin e organizatës, aktivitetet, etj.

V. PJESËMARRJA E STAFIT NË TRAINIME

- **“Identifikimi i rasteve të trafikimit të Brendshme të Fëmijëve: sfidat dhe zgjidhjet”**, organizuar nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Trainim mbi **“Intervistimi i të miturve, viktimave të abuzimit seksual”** organizuar nga ICITAP;
- Trainim mbi **“Raste të abuzimit me substanca”**, organizuar nga D&E dhe ofruar nga qendra “Emanuel”;
- **“Abuzimi Seksual i Fëmijëve – Ndërtim i Shërbimeve të Specializuara”**, trainim i organizuar nga Terre des Hommes;
- Trainim mbi **“Dizajnimi i Projektesh”** organizuar nga D&E për stafin e D&E kryesisht atë menaxherial;
- **“Menaxhim Efektiv – Shërbime Cilësore”**, trainim për ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale nga organizata të shoqërisë civile në Shqipëri dhe Maqedoni, organizuar në Ohër, Maqedoni nga Rrjeti Rajonal IRIS;
- Trainim mbi **“The MIMA Media Course: Social Media and Branding”**, organizuar nga Ambasada Amerikane dhe Partners Albania.;

- Trajnim me temë **“Për edukimin publik mbi të drejtat e pronësisë në këndvështrimin gjinor”**, organizuar nga “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)” me mbështetjen e Entit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN WOMEN).
- **Seminar për Reformën Kushtetuese nga perspektiva akademike dhe civile**, organizuar nga Qendra “A.L.T.R.I” me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, (Soros).
- Dy **seminare për Prokurimet publike për shërbimet sociale**, organizuar nga organizata “Partnerët Shqipëri”, në kuadër të iniciativës për përmirësimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, një iniciativë rajonale e financuar nga Bashkimi Evropian.

VI. KOORDINIME ME AKTORË TË TJERË KUNDËR TRAFIKIMIT

D&E ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti –Trafik:

- Hartimi i Strategjisë Kombëtare i Luftës kunder Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2014-2017;
- Strategjia Kombëtare kundër trafikimit të Fëmijëve;

D&E ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë:

- Konventa e Shërbimeve Sociale;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2014-2020;
- Takime konsultuese mbi Mbrojtjen e Fëmijëve në situatë rruge;
- Hartimi i raportit IV CEDAW;

D&E ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti –trafik.

D&E ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë “Konventa e të Drejtave të Femijëve”; takime të organizuara nga Kuvendi i Shqipërisë, takim i organizuar nga Komisioni i Punës, Ceshtjeve Sociale dhe Shëndetësisë lidhur me “Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”.

Vizitë studimore, shkëmbime eksperiencash me stafin e organizatës “Medaille Trust” në Angli, përfaqësues të policisë, etj, organizuar nga D&E dhe Medaille Trust; gjithashtu vizite studimore për **“Asistimi i minoreneve të pashoqëruar dhe njohja me sistemin e foster care në Angli”**, organizuar nga Sherbimi Social Croydon, Angli.

“Të Ndryshëm & Të Barabartë” si pjesë e projektit “Zërat tanë”, u ftua të merrte pjesë në Takimin e Parë të Grupit të Referimit dhe Shpërndarjes, mbajtur në Londër UK në 10 Dhjetor 2014. Qellimi i këtij takimi ishte të ndante njohuritë dhe praktikën e mira në lidhje me promovimin e përfshirjes së të rinjve në perpjekjet për të parandaluar dhunën seksuale në Europë.

Pjesëmarrje në aktivitetin organizuar në Vatikan, Itali mbi **“Young people against human trafficking and prostitution”**.


Pjesëmarrje e stafit të D&E ne **“Cross-cultural Conference on Trafficking”**, organizuar nga D&E dhe Medaille Trust në Bled, Slloveni.

D&E ka marrë pjesë në shumë konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakta, workshop-e si p.sh: Konferencën *“Lojra të Përgjegjshme”* organizuar nga Lotaria Kombëtare; *aktivitete për Prokurimet publike për shërbimet sociale*, organizuar nga organizata *“Partnerët Shqipëri”*, në kuadër të iniciativës për përmirësimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, një iniciativë rajonale e financuar nga Bashkimi Evropian.

i. BOTIME TË D&E

❖ “Studim mbi çështjet e bashkëpunimit të viktimave të trafikimit me autoritetet e zbatimit të ligjit”

Ky studim u përgatit me mbështetjen financiare të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Qëllimi i studimit ishte të mblidhte, analizonte informacion mbi procesin e kontaktit, identifikimit dhe bashkëpunimit të viktimave të trafikimit me autoritetet e zbatimit të ligjit, përfshirjen e tyre në procesin e hetimit të trafikantëve dhe shfrytëzuesve dhe efektet e këtyre proceseve në rehabilitimin edhe riintegrimin e viktimave, për të dhënë rekomandime të informuara mbi përmirësimin e procesit të identifikimit dhe bashkëpunimit. Grupi i studimit u përbë nga dy nëngrupe: nëngrupi i ofruesve të shërbimit dhe nëngrupi i studiuesve specialistë të zbatimit të ligjit.



❖ Albumi “Unë e lashë të kaluarën pas”

Ky botim është realizuar në kuadër të projektit “EIDHR/2013/335-757: Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri”, I cili zbatohet nga UN Women Shqipëri. Albumi “Unë e lashë të kaluarën pas” përmban piktura të përgatitura nga vajza e gra të mbijetuara trafikimit, të paraqitura për herë të parë në Ekspozitën Ndërgjegjësuese me të njëjtin titull, organizuar nga “Të Ndryshëm & Të barabartë” në bashkëpunim me Zyrën e

Koordinatorit Kombëtar Antitrafik/Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë javës Kombëtare Antitrafik 18-24 Tetor 2014.



❖ **Studim mbi Meshkujt Viktima të Trafikimit në Shqipëri**

Ky vlerësim u krye në kuadër të projektit "Rritja e përpjekjeve riintegruese për viktimat e trafikimit në Shqipëri", i mbështetur nga fondacioni KBF dhe GIZ. Ky vlerësim përpiqet të hedhë dritë mbi një temë të rrallë studiuar dhe vlerësuar në Shqipëri apo në rajon, të tillë si trafikimi i meshkujve. Gjatë këtij vlerësimi janë eksploruar përvojat e trafikimit të 22 meshkujve viktimë të trafikimit, identifikimin e tyre, historitë e tyre unike si dhe vështirësitë, sfidat dhe arritjet me të cilat ballafaqohen gjatë procesit të ndihmës.